



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 11 datë 31.1.2024

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS
EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË
SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË
TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%)
PËR NDIHMËN EKONOMIKE.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 31.1.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 21 të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 " Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu IV, pika 1, si dhe bazuar në relacionin e administratës:

VENDOSI

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike, sipas tabelës bashkëlidhur.
 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULLI

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Hasha

Miratuar me 40 vota

Vota Pro 40

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 6.2.2024

KRITERET PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%).

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT (Total 100)	DOKUMENT KONFIRMUES
1	Familje njëprindërore me një ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	19	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle
2	Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura).	17	Çertifikatë familjare
3	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	15	Çertifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor
4	Familje të ngujuara për gjakmarrje.	13	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Dr. Raj. e Policisë së Shtetit
5	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit.	11	Çertifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së denimit/ose kom. mjeko-ligjor
6	Familje me 3 apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	9	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle
7	Familje në proces divorci.	7	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata
8	Familje që kanë anëtarë madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram.	5	Çertifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata
9	Familje të prekura nga fatkeqësitë natyrore.	3	Çertifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë
10	Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike.	1	Çertifikatë familjare